

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ERSA CONSTRUCTION” shpk**

Në Tiranë, sot më datë \_\_\_13\_\_\_ Janar 2023,

**Z.Erjon Abazi**, atësia Hazbi , i dtl. 07/07/1992, lindur në Laknas dhe banues në Kamëz, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet leternjoftimit ID Nr **J20707117V**,

**dhe**

**Z.Sokol Ndoci**, atësia Ndue , i dtl. 07/06/1988, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet leternjoftimit ID Nr **I80607117A**,

të cilët me cilësinë e “Ortakëve Themelues”, me vullnet të lire, të plote e të sinqertë dhe iniciativën e lire private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendosen krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë “ERSA CONSTRUCTION” shpk me të dhënat e mëposhtme:

**KREU I**

**Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti**

Neni 1  
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ERSA CONSTRUCTION” shpk.

Neni 2  
Forma Juridike

Shoqëria “ERSA CONSTRUCTION” shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3



## Selia

Tiranë ,Njësia Bashkiake Nr.5,Rruga Komuna e Parisit,Nd.1,Pasuria nr.1/24+5-B/1,Zone Kadastrale 8270.

Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetem.

## Neni 4 Objekti

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë:

Import - Eksport, prodhim dhe tregtim i produkteve Fino, Llag te gatshem, Kolle. Punime te pergjithshme ndertimi, punime germimi, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile industriale de veshje fasadash. Rruge, autosdrada, ura, mbikalime hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudha me kavo dhe pista aeroportuale. Punime nentokesore, ura e vera arti. Diga,tunele hidroteknike. Ujesjelles, gazesjelles, vajsjelles, vera kullimi e vaditje. Ndertime detare e punime thellimi nen uje. Punime dhe mbrojtje lumore , sistemime hidraulike de bonifikime. Ndertimi i impianteve te prodhimit te energjise elektrike. Ndertime per n/stacionet kabinat e transformatoreve e linjat e tensionit te mesem, dhe shperndarjen e energjise. Punime te inxhinierise se mjedisit.Punime special ndertimi. Punime per prishjen e ndertimeve. Impiante hidrosanitare kuzhina, lavaneri,mirembaitia e tre. Impiante ngritese de transportuese (ashensore,shkalle levizese, transportues). Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik de xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut. Sinjalistike rrugore jondricuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore.Ndertime parafabrikat b/a, struktura metalike dhe druri. Punime strukture speciale. Shtresa dhembistruktura speciale. Punime mbi shina dhe traversa. Impiante teknologike termike dhe te kondiciontmit.Impiante dhe linja telefonike de telekomunikacioni. Impiante te brendshme elektrike, telefomi, radiofoni,TV etj. Pastrim i ujrave detare, ligenore de lumore. Ndertimi i impianteve te ujit te pishem dhe pastrimit te tij. Ndertimi i impianteve te grumbullimit de trajtimit te mbetejeve urbane. Punime topogjeodezike. Sistemet kundra zhurmes ne infrastrukture. Shpime geologe - inxhinierike, puse e shpime per uje. Agjensi shitjeblerje, transporti. Prodhim te duralumin, alukobond, xham struktural etj. Import eksport te materialeve te te gjitha llojeve. Agjensi udhetimi e turistike, sherbim hotelerie, bar, restorant, fast-food. Transport mallrash he udhetaresh he cdo lloi aktiviteti tjeter te lejuar me ligj. Tregtim me shumice he pakice te artikujve te ndryshem, import -eksport te mallrave te ndryshem ushqimor, industrial, elektroshtepiak, prodhim konfeksionesh, produkte bujgesore, material ndertimi, inerte, vela auto. Punime te pergjithshme ndertimi: Punime germimi, ndertime civile de industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash, civile industriale de veshje fasadash. Rruge, autostrada, ura mbikalime, hekurudha, linja tramvaj metro, hekurudha me kavo he pista aeroportuale. Punime nentokesore, ura e vera arti. Diga, tunele hidroteknike. Ujesjelles, gazesjelles, vajsjelles, vera kullimi e vaditje. Ndertime detare e punime thellimi nen uje. Punime he mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndertimi i impianteve te prodhimit te energise elektrike. Ndertime per n/stacionet kabinat e transformatoreve linja te tensionit te mesem, he shperndarjen e energise. Punime te inxhinierise se mjedisit dhe ndertim dhe punime speciale ndertimi. Punime te pergjithshme ndertimi, punime germimi, ndertime civile de industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash, civile industriale he veshje fasadash. Rruge, autosdrada, ura mbikalime hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudha me kavo he pista aeroportuale. Punime nentokesore, ura e vepra arti. Diga, tunele hidroteknike. Ujesjelles, gazesjelles, vajsjelles, vera kullimi e vaditje. Ndertime detare



e punime thellimi nen uje. Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike he bonifikime. Ndertimi i impianteve te prodhimit te energise elektrike. Nderime per n/stacionet kabinat e transformatoreve e linja e tensionit te mesem, he shperndarjen e energjise. Punime te inxhinierise se miedisit. Punime speciale ndertimi. Punime per prishjen e ndertimeve. Impiante hidrosanitare kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Impiante ngritese de transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues). Punime rifiniture te muratures he te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe hami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut. Sinjalistike rugore jo ndricuese. Barriera dhe mbroitie trugore. Nderime parafabrikat b/a, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore speciale. Shtresa dhe mbistruktura speciale. Punime mbishina de traversa. Impiante teknologjike termike dhe te kondicionimit. Impiante dhe linja telefonike he telekomunikacioni. Impiante te brendshme elektrike, telefomi, radiofoni, TVetj. Pastrim i ujrave detare, ligenore dhe lumore. Ndertimi i impianteve te ujit te pishem dhe pastrimitte tij. Ndertimi i impianteve te grumbullimit de trajtimit te mbetejeve urbane. Punime topogjeodezike... Ushtrimin te cdo veprimtarie te ligishme, te lejueshme per formen e shogerise e cila nuk ndalohet me ligi { sipas nenit 7 te Ligjit tregtar nr. 9901, dt. 14.04.08.

Për kryerjen e aktiviteteve të shoqërisë së mësipërme për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**KREU II**

**KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (një qind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 pjesë dhe vlera nominale e një pjese është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Ky kapital zotërohet në masën 1 pjesë nga ortaku Z. Erjon Abazi barabartë me 50% dhe vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe në masën 1 pjesë nga Z.Sokol Ndoci e barabartë me 50% dhe vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)  
Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqytjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### Neni 10

#### Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi. Administrator i shoqërisë **“ERSA CONSTRUCTION”** shpk zgjidhet Z.Florian Demushi , i dtl. 22.03.1998 madhor me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Letërnjoftimit ID me Nr.032578486 dhe Nr. Personal **J80322023N**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë

financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13  
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16  
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "ERSA CONSTRUCTION" shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

#### ORTAKËT THEMELUES

**ERJON ABAZI**

*Erjon Abazi*  


**SOKOL NDOCI**

*Sokol Ndoçi*  
